




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit 09nr. Ref. 162/20 dt. 28.05.2020 të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR SHITJE TË MASËS DRUSORE

1. Lejohet shitja e masës drusore në sasi prej 125.80 m³ – lloji i drurit Pisha e cila ndodhet në terrenin e Çyqavices , parcela nr. P-70202010-00794-0 nr. P-70202010-00795-0, nr. P-70202010-00796-0 në vendin e quajtur Oblevik/Teraxhë (te pishat), pronë publike e Komunës (pronë shoqërore pylltaria) të cilat janë dëmtuar nga zjarri i ndodhur vite më parë. Shitjes duhet të i paraprij një plan i hartuar konform dispozitave ligjore-nënligjore për pyjet e Kosovës.
2. Obligohet Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural që të zhvilloj procedurat për shitje të masës drusore, konform me dispozitat e Ligjit nr. 2003/3, për Pyjet e Kosovës, Ligjit nr. 2004/29 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-153 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit nr. 2003/3, Udhëzimit Administrativ nr. 06/2010 për Mënyrat dhe Procedurat e Shitjes së Trungjeve Pyjore dhe Arsimentet Drusore nga Pyjet Publike, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 14/2011 për Ndryshimet dhe Plotësimet e UA nr. 06/2010.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 434/20

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 01.06.2020

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “g” të Statutit të Komunës, si dhe në kërkesë të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural , nr. prot. 17744/20 dt. 01.06.2020, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Shoqata “Handikos” në Vushtri lirohet nga participimi për ngritje të dy serrave me sipërfaqe prej 50 m2, në kuadër të projektit të komunës për ngritje të serrave për vitin 2020.
2. Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural do të lidhë kontratë me përfaqësuesin e Shoqatës “Handikos” në Vushtri për mënyrën dhe kushtet e dhënies në shfrytëzim të serrës.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Shoqatës “Handikos” në Vushtri
- Arkivit të Sekretarisë.



REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 436/20

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 01.06.2020

VUSHTRRI - VUČITRN




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Me qëllim të vënies së rregullit, rendit dhe sigurisë në objektin e komunës përkatësisht hyrje daljeve nga ana e palëve, përveç masave të deritanishme të parapara me Urdhëresën nr. 94, dt. 31.01.2020, urdhëroj që të merren edhe këto masa shtesë:
 - 1.1 Në hyrjen e prapme të objektit të komunës të ndalohet strikt hyrja për palë. Kjo hyrje të shfrytëzohet vetëm për zyrtar komunal ashtu siç është e dedikuar. Punëtori i sigurimit do të kujdeset që mos të lejojnë hyrjen e palëve edhe nëse janë të shoqëruar nga ndonjë zyrtar komunal.
 - 1.2 Palët që kërkojnë takim te Kryetari apo Nënkryetari i Komunës, të lejohen vetëm ditëve të caktuara për punë me palë. Punëtori i sigurimit duhet të mbaj fletore të shënimeve zyrtare në të cilën duhet të i merren të dhënat personale palës duke shënuar kohën dhe orën e prezencës në objektin e komunës. Deri sa të zgjatë pandemia COVID-19, palët duhet të jenë të pajisura me masa mbrojtëse (maska dhe dorëza).
 - 1.3 Të njëjtat rregulla duhet të vlejnjë edhe me rastin e pranimi të palëve nga Drejtorët e Drejtorive.
2. Drejtori i Drejtorisë për Administratë do të merr masa për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj urdhërese dhe do të raportoj çdo fillim jave përmes raporteve javore te kryetari i komunës.
3. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	441/20
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	05.06.2020
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 1 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 4 paragrafi 2, pika 2.4. nënpika 2.4.3, nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 05.06.2020 merr këtë:

V E N D I M
PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHPRONËSIM TË PRONAVE TË
PALUEJTSHME

Neni 1

Fillohet procedura e shpronësimit të pronës të paluejtshme të pronarit privat/ zotëruesit të interesit, për qëllim të interesit publik – realizimi i projektit për rregullimin dhe zgjerimin e rrugës "2 Maji" në Vushtri, Komuna Vushtri, për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:


- P-70202016-03022-2, në sipërfaqe prej **22 m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 963 m², ZK-Vushtri, pronar në pjesë ideale 1/1 Ismet (Idriz) Kurti nga Vushtria, Komuna Vushtri.
- P-70202016-03023-0, në sipërfaqe prej 58 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1963 m², ZK-Vushtri, pronar në pjesë ideale 1/1 Halim (Muharrem) Selaci nga Vushtria, Komuna Vushtri.

Neni 2

Shpronësimi i pjesëve të parcelave kadastrale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me kompensim, konform dispozitave të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Neni 3

Vlerësimin për kompensimin e shpronësimit e bën Zyra për Vlerësim të Pronës së pa Luajtshme pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Shtabi Emergjent për Mbrojtje nga COVID-19

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/38, datë 31.05.2020, Shtabi Komunal Emergjent për Mbrojtje nga Korona Virusi, COVID-19, pas shqyrtimit të gjendjes së krijuar nga përhapja e Korona virusit në ditët e fundit në Komunën e Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 05.06.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet blerja e njëmijë (1000) pakove ushqimore dhe higjienike në vlerë deri në pesëdhjetë euro (50,00 €) të cilat do të iu shpërndahen familjeve që janë tani aktive, të prekura me COVID-19 në Komunën e Vushtrrisë.
2. Mjetet financiare për blerje të pakove të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi të sigurohen nga kodi buxhetor i komunës i dedikuar për mbrojtje nga COVID-19.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Komisioni Komunal për shpërndarje të ndihmave me pako ushqimore dhe higjienike.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës – Kryesues i
Shtabit Emergjent

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Prokurim Publik
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Shtabi Emergjent për Mbrojtje nga COVID-19



Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/38, datë 31.05.2020, Shtabi Komunal Emergjent për Mbrojtje nga Korona Virusi, COVID-19, pas shqyrtimit të gjendjes së krijuar nga përhapja e Korona virusit në ditët e fundit në Komunën e Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 05.06.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Fëmijët – nxënës të klasëve të 9-ta dhe personeli tjetër i shkollave në Komunën e Vushtrrisë, në familjet e të cilëve ka persona të infektuar me virusin COVID-19, nuk do të vijojnë mësimin në shkollat e tyre deri në një vendim tjetër të Shtabit Emergjent, për shkak të rrezikut të përhapjes së këtij virusi te nxënësit tjerë apo personelit tjetër i punësuar në ato shkolla.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria Komunale për Arsime.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Xhafa Tahiri
Kryetar i Komunës – Kryesues i
Shtabit Emergjent

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	453/20
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	09.06.2020
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Shtabi Emergjent për Mbrojtje nga COVID-19

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/38, Shtabi Komunal Emergjent për Mbrojtje nga Korona Virusi, COVID-19, në mbledhjen e mbajtur në distancë më 08.06.2020, pas shqyrtimit të gjendjes së krijuar nga përhapja e Korona virusit në ditët e fundit në Komunën e Vushtrrisë, merr këtë:

V E N D I M

1. Fëmijët parashkollor në Çerdhen e Fëmijëve "Foleja" në Vushtrri, nuk do të vijojnë ardhjen e tyre në këtë çerdhe deri në një vendim tjetër të Shtabit Emergjent, për të parandaluar mundësinë e infektimit me koronavirus, duke ditur se kjo sëmundje ditëve të fundit ka shënuar rritje të numrit të infektuarve në Komunën e Vushtrrisë.
2. Kjo masë do të vlejë deri në një vendim tjetër të Shtabit Emergjent.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria Komunale për Arsim.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës – Kryesues i
Shtabit Emergjent

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nën 8 pika 2, 3 dhe 4 të Rregullores së MF – NR. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve si dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr,

V E N D I M
PËR THEMELIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE PËR OJQ-të
E KOMUNËS

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për vlerësim të aplikacioneve sipas thirrjes publike të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport publikuar më 05.06.2020 për ndarje të subvencioneve për OJQ-të e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2020.
2. Komisioni Vlerësues ka këtë përbërje:
 - 2.1 **Burim Rexhepi**, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, - kryesues
 - 2.2 **Liridon Hajdini**, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, - anëtar
 - 2.3 **Ragbete Krasniqi**, Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, zëv.anëtare.
 - 2.4 **Drita Dibrani**, Shoqëria Civile
 - 2.5 **Edina Imeri**, Shoqëria Civile
 - 2.6 **Rexhep Gërguri**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, - anëtar
3. Anëtar i rezervë do të zëvendësoj në rast nevojë anëtarin e Komisionit Vlerësues i cili ka konflikt interesi me ndonjërin prej aplikuesve për subvencion.
4. Komisioni Vlerësues me rastin e vlerësimit të aplikacioneve dhe përzgjedhjes së përfituesve do të zbatoj procedurat e përzgjedhjes konform dispozitave të Rregullores së MF – NR. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
5. Komisioni Vlerësues në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision. Këto rregulla bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.
6. Komisioni Vlerësues ka mandat deri në fund të vitit 2020.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i iu dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport,
- Anëtarëve të Komisionit Vlerësues
- Arkivit të Sekretarisë.



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 461/20

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 15.06.2020

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Shtabi Emergjent për Mbrojtje nga COVID-19

Shtabi Komunal Emergjent për Mbrojtje nga Virusi, COVID-19, pas shqyrtimit të gjendjes së krijuar nga përhapja e korona virusit në ditët e fundit në Komunën e Vushtrrisë, si dhe me qëllim të ruajtjes së shëndetit të nxënësve nga sëmundja COVID-19 në mbledhjen e mbajtur më 12.06.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Mësimi plotësues i ambientimit dhe përgatitjes së nxënësve për testin e arritshmërisë të klasëve të 12-ta të mbahet në formën on-line (në distancë). Ky vendim merret pas konsultimeve me Ministrinë e shëndetësisë, IKSHP dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, përmes kryetarëve të komunave dhe Drejtorëve komunal të arsimit si dhe bazuar në rrezikun e përhapjes së këtij virusi te nxënësit tjerë- apo personelit tjetër i punësuar në ato shkolla.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria Komunale për Arsim.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës – Kryesues i
Shtabit Emergjent

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRIN	
02 Nr. / Br	469/20
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	16. 06. 2020
VUSHTRRI - VUÇITRIN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA/REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI
VUSHTRRI MUNICIPALITY / OPŠTINA VUCITRN

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 4, dhe neni 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 16.06.2020 merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

Neni 1

KONSTATOHET se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1 deri 1.4, paragrafi 1 i nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për qëllim të përfitimit të ligjshëm publik-realizimi i projektit për rregullimin e rrugës "Adnan Shyti" në Vushtri, Komuna Vushtri për pjesën e parcelës kadastrale si në vijim:

- P-70202016-04078K-0, në sipërfaqe prej 250 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7817 m2, ZK-Vushtri, bashkëpronar në pjesë ideale 1/4 Bahri Imer Xhaferi, Smajl Imer Xhaferi, Xhemail Imer Xhaferi dhe Hetem Imer Xhaferi, nga fshati Doberllukë, Komuna Vushtri.

Neni 2

Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, do të njoftohet me vendimin preliminar pronari/zotëruesi i interesit të pronës e cila do të shpronësohet.

Neni 3

Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit, vendimi preliminar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën ditore "Zëri" në Kosovë.

Neni 4

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 15 ditëve pas hyrjes në fuqi, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, konform nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe

plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010. Ankesa mund të paraqitet nga pronari ose zotërues i interesit në pronën e prekur nga ky vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare dhe në Gazetën ditore "Zëri" në Kosovë.

 Kryetari i Komunës
Xhafer Tahiri